



Në bazë të Rregullorës për pagesa të shkollimit, dispozitave të neni 25, paragrafi 4, pika F, si dhe neni 54 të Statutit të Kolegjit UBT dhe në harmoni me nenin 30, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Rregullores për organizimin e studimeve, Rektori i UBT-së miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Pagesa e studimeve për studentët të cilit regjistrohen në vitin akademik 2021/2022, janë si më poshtë:
- Në nivelin Baçelor pagesa për një vit akademik është 1 200 €, përjashtim bëjnë pagesat për programet për të cilat është vendosur ndryshe me këtë vendim;
 - Në nivelin Master pagesa për një vit akademik është 1 500 €;
 - Në programin e studimeve Farmaci dhe Stomatologji pagesa për një vit akademik është 4000 €;
 - Pagesa për një vit akademik është 1800 €, në programet e studimeve, si më poshtë:
 - a) Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi;
 - b) Teknik i Anesteziolojisë
 - c) Teknik i Radiologjisë.
 - Pagesa për një vit akademik është 1500 €, në programet e studimeve, si më poshtë:
 - a) Arte dhe Media Digjitale pagesa për një vit akademik është 1 500 €;
 - b) Infermieri pagesa për një vit akademik është 1 500 €;
- II. Për vitin akademik 2021/2022, Kolegji UBT ofron bursa studimore – zbritje të çmimit të regjistrimit të studimeve themelore sipas kriterëve të mëposhtme:
- Studentët të cilit kanë arritur 100 % në testin kombëtarë dhe kanë të gjitha pesa (5) në shkollimin paraprakë, zbritje prej 50% për vit akademik (për vitin e parë akademik të regjistrimit, e njëjta bursë vazhdohet vetëm për studentët të cilët në afatet e rregullta të provimeve të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër);
 - Studentët me sukses të shkëlqyeshëm, zbritje prej 20% (për vitin e parë akademik të studimeve, e njëjta bursë vazhdohet vetëm për studentët të cilët në afatet e rregullta të provimeve të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër);
 - Studentët në familjet e dëshmorëve të luftës, zbritje prej 15% (kjo zbritje vlen vetëm për vitin e parë akademik të studimeve. Studentet të cilit pas vitit të parë të studimeve në afatet e rregullta të provimeve kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër, përfitojnë zbritje prej 20% nga çmimi bazë);
 - Studentët e punësuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, zbritje prej 10% (kjo zbritje vlen vetëm për vitin e parë akademik të studimeve. Studentet të cilit pas vitit të parë të studimeve në afatet e rregullta të provimeve kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër, përfitojnë zbritje prej 20% nga çmimi bazë);



- Studentët e punësuar në Doganat e Kosovës, zbritje prej 10% (kjo zbritje vlen vetëm për vitin e parë akademik të studimeve. Studentet të cilit pas vitit të parë të studimeve në afatet e rregullta të provimeve kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër, përfitojnë zbritje prej 20% nga çmimi bazë);
- Studentët e punësuar në Policinë e Kosovës, zbritje prej 10% (kjo zbritje vlen vetëm për vitin e parë akademik të studimeve. Studentet të cilit pas vitit të parë të studimeve në afatet e rregullta të provimeve kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër, përfitojnë zbritje prej 20% nga çmimi bazë);
- Studentët e punësuar në Institucionet Publike të Republikës së Kosovës, zbritje prej 10% (kjo zbritje vlen vetëm për vitin e parë akademik të studimeve. Studentet të cilit pas vitit të parë të studimeve në afatet e rregullta të provimeve kanë të përfunduara të gjitha provimet e vitit përkatës me notën mesatare 9.00 e sipër, përfitojnë zbritje prej 20% nga çmimi bazë);
- Studentët që vijnë nga i njëjti rreth i familjes, zbritje prej 10% (për programin e studimeve në tërësi);
- Studentët të cilët regjistrohen në grup (mbi 5 vetë), zbritje prej 10% (për programin e studimeve në tërësi);
- Studentët të cilët regjistrohen në grup (mbi 30 vetë), zbritje prej 15%, ndërsa ata të cilin kanë suksesin e shkëlqyeshëm përfitojnë maksimalisht 25% zbritje (për programin e studimeve në tërësi);
- Studentët të cilët paguajnë komplet shumën e pagesës, zbritje prej 15% (të shumës së paguar për vitin akademik);
- Studentët të cilët paguajnë komplet shumën e pagesës dhe janë përfitues të ndonjëres prej bursave të këtij vendimit, përfitojnë zbritje prej 5% (të shumës së paguar për vitin akademik);
- Studentët të cilët regjistrohen në UBT dhe nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës (Preshevë, Medvegjë, Bujanovc, si dhe nga Mali i Zi ose janë shtetas të huaj) do të kenë zbritje prej 15% (të shumës së paguar për vitin akademik);
- Studentët që marrin pjesë në programin parapërgatitor (studentët e këtij grupi të zbritjes konfirmohen nga zyrtari i UBT-së), zbritje prej 15% (për programin e studimeve në tërësi);
- Studentet të cilit janë kategori sociale dhe të cilit dëshmojnë nga institucionet gjegjëse një status të tillë, rektori me vendim të veçantë shqyrton mundësin e ofrimit të zbritjes për studime.

III. Në nivelin master zbritja për studimet në tërësi prej 30% aplikohet për studentet që kanë përfunduar studimet themelore në UBT dhe vazhdojnë në nivelin master në UBT, ndërsa nuk mund të aplikohet asnjë zbritje tjetër.

IV. Rektori rezervon të drejtën që rastet e veçanta të zbritjeve t'i aprovojë.

V. Studenti i cili gjatë studimeve i humb kriteret për të cilat ka përfituar bursën, kthehet në pagesën bazë të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij vendimi.



- VI. Zbritja e theksuar në këtë vendim, nuk aplikohet për programet Infermieri, Teknik i Radiologjisë, Teknikë i Anesteziologjisë, Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi, Arte dhe Media Digjitale, Stomatologji dhe Farmaci.
- VII. Studenti i cili plotëson kriteret e theksuara më lartë, mund të realizojë të drejtën e vetëm njëërës prej zbritjeve (perjashtim bënë rasti kur student i është përfitues i ndonjëërës prej zbritjeve të theksuara më lartë dhe realizon pagesën në tërësi për vitin akademik, përfiton 5% zbritje plotësuese), dhe nuk mund të aplikohen dy e më shumë zbritje në të njëjtën kohë.
- VIII. Pagesa e shumës së studimeve për vitin akademik 2021/2022 bëhet maksimumi me 12 këste të barabarta mujore, me ç'rast student i realizon dy këstet e para me rastin e regjistrimit, ndërsa pjesa tjetër ndahet në këste të barabarta.
- IX. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Shërbimi i UBT-së.
- X. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Rektori

Prof. Dr. Edmond Hajrizi

